



# SUKSESI YNË



# SHKËLQËN

## ROLI I DEMOKRACISË NË JETËN TONË

ENIS (14), LEONITA (15), ENISE (15), AJETE (14), ERSA (15), MERITA (15)



### Mësojeni se sa e rëndësishme është demokracia për të gjithë ne

Demokracia na ndjek kudo. Ajo është e pranishme që nga momenti kur zgjohemi në mëngjes, dalim në rrugë, shkojmë në shkollë, jemi në punë, etj. Për ta vërtetuar këtë, përmendim elementet e demokracisë, të cilat janë: respekti, barazia, shprehja e lirë, toleranca, solidariteti, paqja, etj. Nëse nuk i zbatojmë këto elemente në shtëpi, në rrugë apo në shkollë, ne nuk do të mund të kemi një jetë të mirë. Paramendojeni sikur në shkollë t'iu trajtonin si jo të barabartë apo edhe më keq, të mos kishit të drejtë të shkoni në shkollë, sepse i takoni fesë tjetër, racës apo kombit tjetër. Paramendojeni sikur moshatarët tuaj të mos kalonin kohë me ju, sepse ju keni gjendje ekonomike më të dobët se ata. Për këtë arsye, jemi me fat që e kemi demokracinë. Demokracia është si një çarçaf që i mbështjell të gjithë njerëzit pa dallime, duke i mbrojtur ata nga diskriminimi, jo drejtësia, konfliktet, etj. Megjithatë, të gjithë ne mbajmë një pjesë të këtij çarçafi në dorë, prandaj duhet ta ruajmë dhe të kujdesemi për të.

Të gjitha shtetet e botës për të pasur progres, udhëhiqen në një rën formë apo tjetrën. E, një ndër format e udhëheqjes është demokracia. Kjo formë e udhëheqjes i jep popullit të drejtën e zgjedhjes që nënkupton se populli udhëheq. Kjo bëhet me anë të votës, ku populli i zgjedh përfaqësuesit e vet. Këta përfaqësues kanë për detyrë të na përfaqësojnë neve, meqë


ne i zgjedhim. Demokracia ka dy forma kryesore, e ato janë: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë. Kosova jonë ka demokraci përfaqësuese, sepse ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë dhe ata marrin vendime në emrin tonë. Ndërkaq, në demokracinë e drejtpërdrejtë populli i mer vendimet në mënyrë direkte. Kosova gjithashtu ka sistem parlamentar, sepse demokracia përfaqësuese ndahet në sistemin parlamentar dhe atë presidencial. Ne kemi sistem parlamentar, sepse deputetët e zgjedhin Presidentin. Ndërsa, në sistemin presidencial, Presidentin e zgjedh direkt populli. Ne gëzojmë shumë të drejta sepse jemi popull i një vendi demokratik. Mirëpo, këto të drejta duhet të respektohen nga të gjithë. E dijmë se kemi të drejtë të shprehemi lirshëm, mirëpo duhet të kemi parasysh se nuk duhet të shprehemi deri në atë masë sa mund ta lëndojmë apo ofendojmë dikë. Kjo është demokracia jonë e çmuar me të gjitha vlerat e saj. Andaj, ta ruajmë atë që ta kemi gjithmonë.



Gazetarët e artikullit

# TRUNGU I PUSHTETEVE

EDONIT (15), ARJETA (15), FLORENT (15), GENTA (15), ELMA (14), MIRJETA (15)



**A dëshironi të dini për pushtetin dhe si ndahet ai? A dëshironi të dini më shumë rreth Kushtetutës së Kosovës? A dëshironi të dini më shumë rreth Kuvendit, Qeverisë dhe gjykatave? Për këto dhe shumë gjëra të tjera, mund ta lexoni artikullin tonë**


Së pari, duhet cekur se çfarë është pushteti. Fjala pushtet nënkupton forcën ose udhëheqjen, të cilën e ka një person ose një grup personash.



**Kështu duken gazetarët e demokracisë**

Në radhë të parë populli ka të drejta të shumta. Ai mund të zgjedh deputetët e Kuvendit të Kosovës. Pastaj kalojmë tek Kushtetuta, e cila është akti ligjor më i lartë i një vendi. Kushtetuta përbëhet prej disa neneve, që gjithsej janë 162 nene. Ky libër konsiderohet ligj mbi ligje. Kuvendi është institucion legjislativ dhe paraqet Pushtetin Legjislativ. Qohet kështu, sepse ai ka detyrë të bëjë miratimin e ligjeve dhe i përshtat ato me Kushtetutën. Qeveria paraqet Pushtetin Ekzekutiv dhe si e tillë bën ekzekutimin e ligjeve. Në Qeveri punojnë


Kryeministri, ministrat, etj. Gjykata është institucion gjyqësor. Në Kosovë kemi tri lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Gjykatat japin dënime në bazë të ligjeve dhe gjykojnë personat për të cilët dyshohet që kanë kryer një krim. Këto institucione janë të ndara, sepse puna është më e lehtë, udhëheqësit kanë më pak stres si dhe nuk mund të abuzohet me pushtetin. Kjo ndodh edhe tek loja e futbollit, ku secili lojtar ka rolin e vet. Aty ka mbrojtës, portier, sulmues, gjyqtar, etj. Kjo ishte gjithçka që përgatitëm për ju për temën e ndarjes së pushtetit. Shpresojmë t’iu ketë pëlqyer dhe të keni mësuar shumë gjëra të reja.



**Trungu i demokracisë**

## PËRFAQËSUESIT E POPULLIT

ZOTRIM (14), ALBINOTA (14), ALBIN (14), BLERTINA (15), BLEONA (14), MARIGONA (15)



### Deputetët janë përfaqësues të popullit, të cilët janë të zgjedhur nga populli me vota të lira

Të dashur lexues, në artikullin tonë do të njoftoheni më shumë rreth deputetëve dhe punës të cilën e bën Kuvendi i Kosovës. Fjala deputet e ka kuptimin përfaqësues, sepse është populli ai i cili me anë të votës ua jep të drejtën deputetëve ta përfaqësonë vendin për disa vjet. Të drejtën për të kandiduar për deputetë e kanë të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare. Kandidatët për deputetë mund të jenë kandidatë të pavarur ose t'u përkasin partive të ndryshme politike.

Sipas aktit më të lartë juridik, Kushtetutës, deputetët edhe pse i përkasin partive politike, zgjedhen nga populli dhe duhet t'i përfaqësojnë interesat e popullit. Pasi që të mbahen zgjedhjet qendrore, kandidatët të cilët kanë fituar votat e mjaftueshme bëhen deputetë dhe e bëjnë Betimin e deputetëve.

Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. 100 prej tyre i përkasin kombit shqiptar, ndërsa të tjerët janë të komuniteteve jo shumicë. Pra, Kuvendi i Kosovës është i përbërë nga deputetë të etnive të ndryshme. Nga kjo kuptojmë se Kuvendi është një institucion shumë partiak, i cili luan rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë. Kuvendi i Kosovës është institucioni më i lartë ligjvënës. Kjo sepse e bën miratimin (mos miratimin) e ligjeve. Fillimisht këto ligje janë të njohura si projektligje, të cilat propozohen nga vetë deputetët, Qeveria, Presidenti, por edhe një numër i madh i qytetarëve. Kuvendi si institucion ka tri funksione kryesore. Njëri

prej tyre është funksioni legjislativ. Me këtë funksion kuptojmë miratimin e ligjeve, siç e cekëm më lart. Funksioni i dytë është funksioni i kontrollit që do të thotë se Kuvendi si institucion e bën mbikëqyrjen e punës, të cilën e bën Qeveria. Këtë e arrin përmes pyetjeve, të cilat deputetët ua parashetrojnë ministrave. Si dhe, funksioni tjetër shumë i rëndësishëm, është funksioni përfaqësues, sepse neve na përfaqësojnë deputetët. Nga e tërë kjo që e thamë, kuptojmë se Kuvendi është bërthama e një vendi demokratik. Ose më mirë të themi, Kuvendi është një ndër hallkat më të rëndësishme të një udhëheqjeje demokratike. Kjo sepse, në këtë institucion ka pluralizëm si politik, po ashtu edhe etnik.



Autorët të cilët shkruajtën për Kuvendin dhe deputetët

# ROLI I QYTETARËVE NË DEMOKRACI


EGZONA (15), BLENDI (15), KOSOVARE (15), ALMA (15), DRILONI (14), FJOLLA (14)

**Lexues të dashur, ne do t'iu tregojmë për përgjegjësitë që i kemi ne qytetarët e një shteti demokratik**

Të jetuarit në një shtet demokratik nënkupton lirinë e të shprehurit, të drejtën për të marrë pjesë në procesin zgjedhor dhe të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë me të gjithë të tjerët. Jeta në demokraci të mundëson të jesh pjesë e aktiviteteve të ndryshme shtetërore, e një prej këtyre aktiviteteve është pjesëmarrja në zgjedhje. Ne bëjmë shumë zgjedhje në përditshmëri, por të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhjet shtetërore e kemi nga moshë 18 vjeçare. Në këtë moshë i mendojmë gjërat në mënyrë më të thellë dhe arrijmë të mendojmë më mirë se cilët janë personat të cilët mund të jenë të duhurit për vendin. E mira e zgjedhjeve është se secili qytetar mund të shprehë mendimin lirshëm. Pra, zgjedhjet janë përgjegjësia jonë, e cila ndikon në të mirën tonë. Prandaj, votoni edhe ju, sepse vota juaj bën ndryshime për të gjithë ne.




Votuesit e së ardhmes



Para ligjit të gjithë jemi të barabartë



Në këtë moshë e kemi të drejtën të votojmë



Bëhu edhe ti pjesë e ndryshimit



Të gjithë kemi të drejtë vote pa asnjë lloj dallimi



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Kombit“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Kamenicë